



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1257/11 prot.

Datë 31.01.2024

**V E N D I M**

**Nr. 118/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.01.2024 me

**Objekt:**

“Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: “*Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)*” me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05.05.2023, nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Raimondo G.P” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:**

“Albanian Gas Services Company” Sh.A  
Rruga “Kosovareve”, Pallati: NderPro, Tiranë

**Ankimues:**

“Li.Bo Albania Branch” SHPK, me NUIS M22220501B dhe adresë: Lagjja Nr.3, Sheshi Liria, tek

EGT Center, Ap.18, ndodhur ne ZK.8514, me numër Pasurie 3/319-N18, Kati 2,Durrës

“Trakmar” SHPK me NUIS L01410504A dhe adresë: Lagja nr.14, Rruga “Martin Camaj”, Shkozet, objekt me nr. pasurie 4/472, Zona Kadastrale 8515, Blloku nr.5, Durrës, Tiranë.

**Subjekte të Interesuara:**

“Raimondo G.P” SHPK me NUIS M12304002Q dhe adresë: Lagja 3, Rruga “Grigor Durrsaku”, EGT CENTER, Zona Kadastrale 8514, Nr. pasurie 3/319-N18, Durrës.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës, pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.04.2023, në sistemin e prokurimeve elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

II.2. Në datën 05.05.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt - ankimi.

II.3. Në datën 19.05.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Li.BO-Albania Branch	3.592.000 lekë, skualifikuar
- Raimondo G.P	3.640.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	3.640.000 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	3.801.680 lekë, kualifikuar
- Ligus	4.100.000 lekë, kualifikuar
- Trinity Trade Company	4.198.000 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Li.BO-Albania Branch” SHPK është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

- Per plotesimin e kriterit 2.2.1 ne shtojcen 7 per kontratat e ngjashme OE ka dorezuar ne SPE kopje te faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 ne emer te kompanise meme italiane LI.BO SRL, te cilat nuk jane noterizuar kopjet me origjinalin por vetem noterizimi i perkthimit, si dhe mungon vula apostile.

- E njejta gje konstatohet edhe ne Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015, e cila nuk eshte noterizuar kopja me origjinalin.

- Nuk ploteson kriterin 2.1.1 ne shtojcen 7 per xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument nga administrata tatimore per xhiron ose vetedeklarim nese ky dokument nuk lëshohet nga vendi i origjinës se kompanise meme LI.BO SRL, në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19/05/2021, Nenin 26 ku parashikohet shprehimisht se:

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

II.4. Në datën 26.05.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit.

II.5. Në datën 31.05.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1250/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3147, e operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Li.Bo Albania Branch” SHPK. Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Ju bëjmë me dije se nuk jemi dakord me konstatimet e KVO dhe i kundërshtojmë ato duke u referuar veçanërisht në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik, pasi jemi një Operator Ekonomik që i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara në shtojcën “Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kualifikimit” në Dokumentet e Tenderit të përgatitura nga A.K, kriteret të cilat i konsiderojmë se i plotësojmë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që është prokuruar, duke qenë në lartësinë e një kualifikimi profesional teknik, ekonomik dhe ligjor.*

*I. Për sa i përket arsyes së refuzimit “1-. Për plotësimin e kriterit 2.2.1 në shtojcën 7 për kontratat e ngjashme OE ka dorëzuar në SPE kopje të faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane Li.Bo srl, të cilat nuk janë noterizuar kopjet me origjinalin por vetëm noterizimet e përkthimit, si dhe mungon vula apostile”*

*Për sa i përket kërkesës tuaj se duhet të paraqitej noterizimi i kopjes me origjinalin, ju vëmë në dijeni se faturat janë skanuar nga origjinali dhe nuk ka pasur nevojë për njëhësim të fotokopjes së bërë nga origjinali. Për ligjshmërinë e këtij veprimi është shprehur edhe në DST ku thuhet se Bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në formularin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit Shtojca 8 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentet e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Pra, për sa kohë kriteret e tenderit ishin që: Dokumentet e tenderit duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, automatikisht bie poshtë kërkesa juaj “të njësuara me origjinalin” pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tonë nuk qëndron dhe kërkojmë të rishikohet.*

*Për sa i përket kërkesës tuaj për apostilim të faturave, ju informojmë se referuar konventës së Hagës 5 Tetor 1961, ku Italia dhe Shqipëria janë shtete anëtare të saj, lista e dokumenteve që duhen apostiluar janë vetëm ato dokumente publike të lëshuara nga administrata shtetërore e Italisë dhe jo dokumentet private të lëshuara nga shoqëri apo individë privat që operojnë në treg të pavarur nga Shteti.*

Referuar konventës së Hagës 5 Tetor 1961, Neni 1 i tij citon: (Shiko bashkëlidhur Aneks 1: Konventa që Shfiron kërkesën e Legalizimit të Dokumenteve Publike Te Huaja (përfunduar më 5 TETOR 1961)

Kjo konventë do të zbatohet për dokumentet publike që janë ekzekutuar në territorin e një Shteti Kontraktues dhe që duhet të dorëzohen në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues. Për qëllime të kësaj Konvente, dokumentet e mëposhtme konsiderohen si dokumente publike:

a) dokumente që vijnë nga një autoritet ose një zyrtar i lidhur me gjykatat ose tribunalet e shtetit, duke përfshirë ato që rrjedhin nga një prokuror publik, një nëpunës i një gjykate ose një shërbyes procesi ( huissier de justice );

b) dokumentet administrative;

c) aktet noteriale;

d) certifikatat zyrtare që vendosen në dokumente të nënshkruara nga persona në cilësinë e tyre private, si p.sh. Certifikatat zyrtare që regjistrojnë regjistrimin e një dokumenti ose faktin që ai ka ekzistuar në një datë të caktuar dhe vërtetimet zyrtare dhe noteriale të nënshkrimeve. Megjithatë, kjo konventë nuk do të zbatohet:

a) për dokumentet e ekzekutuara nga agjentë diplomatikë ose konsullorë;

b) për dokumentet administrative që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me operacionet tregtare ose doganore.

Referuar faqes zyrtare të zyrës përkatëse, pranë Ministrisë së Jashtme në Itali, që merret me apostilimet theksohet si më poshtë:

Një apostil mund të kërkohet vetëm për dokumente dhe akte publike. Kjo do të thotë që individët privatë dhe shoqëritë tregtare janë të përjashtuar, (Shiko web: <https://www.esteri.it/it/servizi-consolari-e-visti/italiani-all-estero/traduzione-e-legalizzazione-documenti/legalizzazione-documenti>).

Pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tonë nuk qëndron dhe kërkojmë të rishikohet;

Një sqarim i mëtejshëm: Dega Li.Bo Albania Branch, është identifikuar si seli (degë) e përhershme e Li.Bo.srl.

Mbi bazën e nenit 162 të TUIR (Ligji i Konsoliduar i Tatimit mbi të Ardhurat (TUIR) (Dekreti Presidential i 22 dhjetorit 1986, nr. 917) shprehja seli e përhershme përcakton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit shoqëria jorezidente ushtron të gjitha ose pjesë e veprimtarisë së tij në territorin e shtetit.

<https://def.finanze.it/doctribfrontend/getarticolodetailfromresultlist.do?Id={8052C201-DF5B-4248-AD74-BCA56A4EAF7}&codiceordinamento=200016200000000&idattonormativo={31D6 94E8-4398-4030-873B-FEAF5A6647F9}>

Prandaj, selia e përhershme nuk është mbajtëse e subjektivitetit juridik autonom të ndryshëm nga shoqëria mëmë: është e njëjta shoqëri jorezidente që operon në një shtet të huaj nëpërmjet një selie të përhershme, prandaj nga kjo fiton kërkesat ekonomike, teknike dhe të certifikimit.

Bashkëlidhur do të gjeni materialet referuese:

-Aneks 1: Konventa që shifron kërkesën e legalizimit të dokumenteve publike të huaja

- Aneks 2: Rregullorja (BE) 2016 /1191 e cila promovon lëvizjen e lirë të qytetarëve duke thjeshtuar kërkesat për paraqitjen e disa dokumenteve.

- Aneks 3: Legalizimi i dokumenteve nëpërmjet vendeve anëtare ne konventën e Hagës.

- Aneks 4: përkthimi dhe : Legalizimi i dokumenteve nëpërmjet vendeve anëtare ne konventën e Hagës.

2. Per sa i perket arsyes se refuzimit “2- Certifikata për sistemimin e Menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 e cila nuk është noterizuar kopja me origjinalin”, ashtu sikurse e theksuam edhe në pikën 1 më sipër, bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në formularin e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit Shtojca 8 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentet e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Certifikatat ISO janë të aksesueshme online në web: <https://ëëë.rina.org/en> ne seksionin lista e certifikatave, në fund, duke shkruar numrin e certifikatës. Vlefshmëria e tyre mund të shihet në kohë reale. Ne përputhje me marrëveshjet e njohjes reciproke të organeve akredituese, në rastin konkret ACRREDIA IAF, anëtarë të marrëveshjeve të Njohjes së ndërsjellë të EA, IAF dhe ILAC, certifikata elektronike që mund të shkarkohet drejtpërdrejt nga faqja, është gjithashtu plotësisht e vlefshme në territori shqiptar.

Shiko bashkëlidhur Aneks 7: Certifikata ISO 9001:2015

Për sa kohë kriteret e tenderit ishin që: Dokumentet e tenderit duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin, dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomikë online ishte i skanuar direkt nga origjinali, duke hedhur poshtë kërkesën tuaj “të njehsuara me origjinalin”.

Pra kjo arsye e refuzimit te ofertes tone nuk qendron dhe kerkojme te rishikohet.

3.Per sa i perket arsyes se refuzimit

3- Nuk plotëson kriterin 2.1.1 në shtojcën 4 për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument nga administrata tatimore për xhiron vjetore ose vetëdeklarim, nëse ky dokument nuk lëshohet nga vendi i origjinës së kompanisë mëmë LI.BO srl, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19/05/2021, Nenin 26 ku parashikohet shprehimisht se: operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur bilancet e tre viteve ku është shumë e qartë xhiro vjetore për secilin vit.

Sistemi Italian, ndryshe nga ai Shqiptar nuk konfirmon dorëzimin e tyre, por vetëm depozitohen ne organet tatimore në format elektronik. Prandaj bilancet e shoqërisë janë dërguar në atë format. Dorëzimi i bilanceve nuk mund të konsiderohet si i paparaqitur nga ana jonë, pasi dorezimi i tyre ne formatin elektronik provon dhenien e informacionit, pra dorëzimi i bilanceve, per tre vitet e fundit, duhet te interpretohet nga ana juaj si vetedeklarim nga operatori ekonomik, ashtu sikurse e keni te shprehur qarte edhe ne VKM me nr. 285 date 19/05/2021. Neni 26, “Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. Për sa kohë informacioni i kërkuar nga ana juaj është i qartë dhe i dukshëm në të dhënat e Bilanceve të depozituara nga ana jonë, prandaj dalim në konkluzion se dorëzimi i bilanceve do të konsiderohet si vetëdeklarim nga ana jonë per xhirot vjetore, pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tonë nuk qëndron dhe kërkojmë të rishikohet.

*Deklarata e posedimit të kërkesave të xhiros për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është përfshirë në Aneksin 8, Deklarata e posedimit të kërkesave të përgjithshme të tenderit.*

*Shiko bashkëlidhur*

*- shtojcën 5: Shtojca 8 Roberto deklaratën e përgjithshme të posedimit të kushteve të kërkuara për konfirmim të mëtejshëm, në deklaratë kemi nxjerrë në pah vlerat e xhiros së Li.Bo për trevjeçarin e fundit 19-20-21.*

*- Aneks 6: Pasqyra e qarkullimit të tre viteve të fundit për Li.Bo. Srl 4 .*

*4. Per sa i perket arsyes se refuzimit “Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe do të konsiderohet i paparaqitur. Nuk është e drejtë të refuzoni ofertën tonë me këtë arsye, pasi informacioni në lidhje me xhiron vjetore ju është vënë në dijeni nga bilancet e Li.bo, te cilat mund të interpretohet edhe si vetëdeklarim, pasi ato janë akte të prodhuara nga shoqëria bazuar nga të dhënat financiare të tyre, pra kjo arsye e refuzimit të ofertes tone nuk qendron dhe kërkojme të rishikohet.*

*Duke iu referuar artit. 92 të LPP-së... “Administrata ose stacioni kontraktues, kur e sheh të arsyeshme, kërkon nga ofertuesit sqarime në lidhje me ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e këtyre ofertave në mënyrën më korrekte të mundshme.*

*Pa cenuar dispozitat e këtij ligji, mendojmë se duhet të kishim marrë një kërkesë për sqarim përpara parashikimit të përjashtimit nga tenderi sepse do të kishim dhënë informacionin dhe mjetet zyrtare për të verifikuar që arsye të tilla ishin të pabazuara.*

*Shpresojme në mirekuptimin Tuaj për të gjitha cka ju parashtruar me siper dhe Kërkojme*

*- Pëzullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe të shqyrtohet ankesa jone - Te anulohet vendimi i KVO-se të AK në lidhje me refuzimin e ofertes se Operatorit Ekonomik “Li. BO Albania Branch” SHPK dhe të kualifikohet oferta jone.*

**SHTOJCAT**

*- Aneksi 1: Konventa që heq kërkesën e legalizimit për dokumentet publike të huaja*

*- Aneksi 2: Rregullorja (BE) 2016/1191 për thjeshtimin e qarkullimit të dokumenteve publike*

*- Aneksi 3: Legalizimi i dokumenteve për vendet me Konventën e Hagës*

*- Aneksi 4: Përktimi dhe legalizimi i dokumenteve ndërmjet vendeve me Konventën e Hagës*

*- Shtojca 5: Shtojca 8 Roberto deklaratë e përgjithshme e posedimit të kushteve të kërkuara*

*- Shtojca 6: Deklarata e xhiros për tre vitet e fundit Li.Bo. Srl*

*-Shtojca 7: Certifikata e vërtetuar ISO 9001:2015.”*

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1250/2 date 01.06.2023, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK kundërshton nëpërmjet ankesës me nr. 1250 prot.

II.5.2. Në datën 14.06.2023, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1250/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 26/9 prot., datë 12.06.2023, me objekt: “Dërgohen vendimet e shqyrtimit të ankesave të OE “Trak Mar” SHPK dhe OE “Li.Bo –

Albania Branch” SHPK”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së “Li.Bo” SHPK nr. 26/7 prot., datë 01.06.2023.

Referuar Vendimit të KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së “Li.Bo” SHPK nr. 26/7 prot., datë 01.06.2023, rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “Li.Bo” SHPK. Konkretisht janë pranuar pretendimet e ankimesit në lidhje me pikën 2 të ankesës, pasi rezulton, se KSHA ka vlerësuar, se pretendimet e ankimesit qëndrojnë për këtë pikë dhe merren parasysh nga komisioni.

II.6. Në datën 01.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 e operatorit ekonomik “Trakmar” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Raimondo G.P” SHPK. Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Referuar Ekstraktit Historik nga QKB të “Raimondo G.P” SHPK me NUIS: M12304002Q dhe dokumenteve bashkëngjitur bëhet fjalë për një kompani të krijuar në datën 03.11.2021 me zyrë në adresën: Durrës, Rruga “Grigor Durrsaku”, EGT CENTER, Zona Kadastrale 8514, Nr. pasurie 3/319-N18. Kjo është dhe adresa e vetme e kompanisë pasi tek Ekstrakti Historik, pika 3: “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit “, është bosh, pa asnjë të dhënë të plotësuar/deklaruar.

Duke vazhduar kërkimin për Raimondo G.P, i referohemi kompanisë Li.BO-Albania Branch me NUIS: M22220501B, një kompani e themeluar me datë 20.10.2022.

Ajo që na bën përshtypje dhe që ngremë dyshime janë 2 (dy) elementë:

1. Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch kanë të njëjtën adresë: Durrës, Lagjia Nr.3, Sheshi Liria, tek EGT CENTER, Ap 18, ndodhur ne Zonën Kadastrale 8514 me Numër. pasurie 3/319-N18, Kati 2. ( Referuar ekstrakteve bashkëngjitur).
2. Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch kanë të njëjta të dhëna të njoftuara vullnetarisht: email: [arjana.mecaj@primeadvisory.eu](mailto:arjana.mecaj@primeadvisory.eu). Numër telefoni : 052901240.
3. Gjithashtu vëmë re se dokumenti bashkëngjitur në ekstraktin e QKB të Raimondo G.P me titull: “Depozitimi i pasqyrave financiare” është i përgatitur nga [erisa.rustemi@primeadvisory.eu](mailto:erisa.rustemi@primeadvisory.eu), e cila është e deklaruar gjithashtu dhe tek ekstrakti i Li.BO-Albania Branch.

Duket qartë se KVO nuk ka bërë verifikimet përkatëse të sipër përmendura sipas të cilave duhet të kishte skualifikuar të 2 (dy) operatorët ekonomikë pjesëmarrës (Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch) në përputhje me ligjet në fuqi.

Si ka mundësi që ofertat e paraqitura të jenë të pavarura duke qenë se këto subjekte janë bashkuar në të njëjtën adresë në të njëjtën periudhë, kanë si administrator persona të së njëjtës nënshtetësi, ndajnë ekzaktesisht të njëjtin ambient, personi i kontaktit ( [arjana.mecaj@primeadvisory.eu](mailto:arjana.mecaj@primeadvisory.eu)) është i njëjtë, numri i telefonit të kontaktit është i njëjtë dhe marrin pjesë në të njëjtat procedura prokurimi.

Për sa më sipër, dyshimet tona janë të forta dhe konkrete mbi lidhjen që kanë këto dy kompani, duke mos plotësuar kriterin e vetëdeklarimit të shtojcës 8 të DST shkronja B:



*Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura dhe pikën C të shtojcës 8 të DST mbi konfliktin e interesit, kanë cenuar ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 2, pika “c”, “ç”, “d”, “dh”, neni 3, pika 1, 2 dhe 3.”*

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1257/2 date 02.06.2023, me kriteret që operatori ekonomik “Trakmar” SHPK me anë të ankesës me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023, pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Raimondo G.P” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6.2. Në datën 14.06.2023, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1257/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 26/9 prot., datë 12.06.2023, me objekt: “Dërgohen vendimet e shqyrtimit të ankesave të OE “Trak Mar” SHPK dhe OE “Li.Bo – Albania Branch” SHPK”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së “Trak Mar” SHPK nr. 26/6 prot., datë 31.05.2023.

Referuar Vendimit të KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së “Trak Mar” SHPK nr. 26/6 prot., datë 31.05.2023, rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke argumentuar si vijon:

*“[...] Në procedurën ankimuese, të filluar me kërkesë të palës OE “TrakMar” SHPK, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë të fundit. Në mënyrë që të mbështesë pretendimet e saj, OE ankimues duhet t'i kishte bashkëlidhur kërkesës për fillimin e procedurës ankimuese dokumente ose fakte të ndryshme, të cilat mungojnë, sa i përket provueshmërisë së pretendimit mbi kualifikimin jo të drejtë të OE “Raimondo GP” SHPK.*

*OE “TrakMar” SHPK pjesëmarrës në procedurë, ankohet në lidhje me ofertën e operatorëve konkurrentë, peshat specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që AK dhe struktura ad-hoc e ngritur prej tij për shqyrtimin e ankesës (KSHA), adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i AK ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik.*

*KSHA nuk mund të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike.*

*Pavarësisht këtij fakti, në shërbim të transparencës dhe respektimit të një vendimmarrje të drejtë përtej çdo dyshimi, KSHA vlerësoi ankesën sa i përket këtij pretendimi bazuar në DT, kërkesat kualifikuese si dhe në vlerësimin e KVO.*

*Në kuadër të veprimeve të ndërmarra për sa i përket pretendimit të OE “TrakMar”, KSHA ka dërguar një e-mail duke kërkuar informacion nga subjekti Prime Advisory Albania për*

*lidhjen që ky subjekt ka me OE "Raimondo GP" SHPK dhe "LI.BO-ALBANIA BRANCH" SHPK.*

*Subjekti Prime Advisory Albania ka shpjeguar si më poshtë vijon:*

*"Subjektet tregtare "RAIMONDO GP" ShPK dhe "LI. BO-ALBANIA" ShPK, janë kliente të studios "Prime Advisory Albania" e cila kryen shërbime konsulence financiare, duke iu ofruar mbështetje të gjithë subjekteve tregtare me të cilat bashkepunon. Ne këtu kuader disa kliente të saj me administratore të huaj, duke përfshirë edhe subjektet e sipërpermdura, përdorin adresën tonë elektronike dhe si seli qendrore, por jo operative, adresën ku është e vendosur si seli "Prime Advisory Albania", Lagjja nr.3, Sheshi "Liria", tek EGT Center, ap.18, ndodhur në ZK.8514 me nr. pasurie 3/319-N18, Kati 2, Durrës".*

***Përfundimisht, KSHA e gjen të vlefshëm argumentimin e KVO-së për kualifikimin e OE Raimondo GP duke mos e marrë parasysh ankimin për këtë pjesë.***

***Mbi arsyet e mospranimit të ankesës së OE "TrakMar" shpk:***

*Në zbatim të nenit 81 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar citohet se:*

- 1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*
- 2. Nderhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi,*
- 3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për nderhyrje në ofertë nga ana e operatoreve ekonomike ofertues.*

*Fakti që të dy operatorët ekonomikë kanë të njëjtën adresë apo të dhëna që njoftohen vullnetarisht, nuk janë të dhëna përcaktuese që janë i njëjti operator ekonomik.*

*Nga ana e KSHA, u kryen veprimet verifikuese si më poshtë vijon:*

*U verifikua adresa <https://www.primeadvisory.eu/en/contacts/> e Prime Advisory, ku në objektin e aktivitetit përshkruhet: "Te japë asistencë sipërmarresve dhe shoqërive në aktivitetin e menaxhimit të exporteve në Shqipëri dhe jashtë vendit dhe në mënyrë të vecante ofrojmë formë konsulence për nderkombetarizimin e bizneseve, përfshirë aktivitetet funksionale të lidhura me hapjen e një aktiviteti tregtar në çdo vend të Botes. Aktiviteti i gjetjes së partnerëve tregtar ose industriale, klientëve, agjenteve ose shpërndareshve të autorizuar ose jo. Realizimi i studimeve të fizibilitetit në fushën e nderkombetarizimit të biznesit përfshirë edhe përgatitjen e Biznes Planeve, planeve industriale dhe studime mbi planifikimin fiskal nderkombetar. Organizimi i takimeve B2B midis operatoreve tregtarë të vendeve të ndryshme. Konsulence në realizimin e selive jashtë vendit. Konsulence në fushën e bërjes së shoqërive të huaja dhe M&A nderkombetare. Organizimin e transferimeve të biznesit (transferimeve) jashtë vendit. Kërkimi dhe seleksionimi i personelit për t'u punësuar në selitë e shoqërive në Shqipëri dhe jashtë vendit. Konsulence fiskale, organizative dhe doganore. Aktivitetin e zhvillimit të software-ve për llogaritë të vet apo të tjerëve".*

*Sa më sipër konfirmohet edhe në Regjistrin Tregtar në saj të ekstraktit të regjistrimit pranë QKB për subjektin PRIME ADVISORY ALBANIA, me NUIS L81613507G, përfaqësuar nga Administratorët dhe me adresë: Durrës, Lagjja nr.3, Sheshi "Liria", tek EGT Center, ap.18 ndodhur ne ZK.8514 me nr. pasurie 3/319-Nl8, Kati 2, ku për të dhënat e subjektit për Degët ose zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja të OE "LI.BO - ALBANIA Branch" ShPK rezulton se përfaqësues ligjor i degës/zyrës së përfaqësimit është Z. Roberto Bocca dhe Ekstraktit Historik i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" të OE "Raimondo G.P" ShPK rezulton se administrator është Znj. Lucia Raimondo.*

*Si rrjedhojë konstatohet, se OE "Raimondo GP" dhe OK "Li. Bo-Albania" kanë të njëjtën adresë për efekt të njoftimit pranë shoqërisë e cila ka kryer veprimet procedurale për regjistrimin e biznesit etj., aktivitet ky që ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk krijon apo të krijojë në të ardhmen kushte për konflikt interesi në një ofertë të bashkërenduar. Shtuar këtu, fakti që pikërisht "Li.Bo-Albania" është skualifikuar nga KVO.*

*Duke iu referuar nenit të VKM së sipërcituar si dhe ekstrakteve të OE, nuk rezulton i njëjti ortak apo administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.*

*Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit për këtë pikë nuk qendron dhe nuk merret parasysh nga komisioni i shqyrtimit të ankesës.*

*Në këto kushte, bazuar në sa kemi trajtuar më sipër, komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nga ankuesi nuk qëndrojnë ndaj vendosëm të mos pranojmë ankesën e paraqitur nga OE "TRAK MAR" ShPK nr.26/6 prot, date 31.05.2023, me REF-66587-04-19-2023, me objekt "Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)" dhe fond limit prej 4,854,422 ((katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e dy) lekë pa TVSh."*

II.6.3. Duke qenë se pretendimet e ankimesit përbëjnë një çështje ligjore, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një organ tjetër, Autoriteti i Konkurrencës, i cili ka kompetencën lëndore të hetimit administrativ mbi ekzistencën ose jo të marrëveshjeve të ndaluara mes operatorëve ekonomikë në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik, e cila përbën parakusht për zgjidhjen e themelit të ankimit administrativ pranë KPP, në datën 04.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 555/2023, ku vendosi si vijon:

- 1. Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë "Li.BO-Albania Branch" SHPK me nr.1250 prot, datë 31.05.2023 dhe "Trakmar" SHPK, me nr. 1257 prot, datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: "Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)" me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktor, "Albanian Gas Services Company" Sh.A.*
- 2. T'i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë Komisionin e Prokurimit Publik në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.*

3. Të dërgojë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, kopje të dokumentacionit të administruar në shqyrtimin administrativ nr.1257 Protokoli datë 01.06.2023.

II.6.4. Në datën 12.09.2023, nëpërmjet shkresës nr. 1257/5 prot., me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Autoritetit të Konkurrencës me kërkesën si vijon:

*“Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Konkretisht gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së shoqërisë “TrakMar” SHPK si dhe nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik në Ekstraktet Historike të QKB për dy shoqëritë objekt ankimimi, rezulton se ato lidhen drejtpërdrejtë me pretendime dhe dyshime se ofertat e paraqitur nga operatorët ekonomikë “Raimondo G.P” SHPK dhe “Li.BO-Albania Branch” SHPK nuk janë hartuar në mënyrë të pavarur në kuptim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Ligji nr. 9120 datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.*

*Në këto kushte, referuar lex specialis, KPP gjykon se kompetencat e hetimit administrativ në rast se ofertat e paraqitur nga ana e operatorëve ekonomikë “Raimondo G.P” SHPK dhe “Li.BO-Albania Branch” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, ka elementë të marrëveshjes së ndaluar në kuptim të ligjit, janë kompetencë e Autoritetit të Konkurrencës ndaj dhe, nëpërmjet Vendimit nr.555/2023, datë 04.07.2023 vendosi t’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet në këtë vendim dhe të informojë Komisionin e Prokurimit Publik në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.*

*Sa më sipër, jemi në pritje të një vendimi sa më të shpejtë nga ana juaj.”*

II.6.5. Në datën 30.10.2023, është protokolluar në KPP me nr. 1257/6 prot., shkresa e Autoritetit të Konkurrencës me nr. 373/24 prot., datë 26.10.2023, me objekt: “Kthim - përgjigje”, me përmbajtjen si vijon: “[...] Ju bëjmë me dije se Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 26.10.2023, u shpreh me Vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo- Albania Branch SHPK”. Në zbatim të nenit 43, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, afati i përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar është deri në 6 muaj nga data e vendimit të komisionit për hapjen e hetimit të thelluar. Në përfundim të procedurave hetimore në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo – Albania Branch SHPK Komisioni i Konkurrencës do të shprehet me vendim për të cilin do të viheni në dijeni. Bashkëlidhur ju lutem gjeni Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1026, datë 26.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo- Albania Branch SHPK”.

II.6.6. Në datën 09.01.2024, nëpërmjet shkresës nr. 1257/7 prot., me objekt: “Kërkesë për informacion”, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Prokurimit Publik përsëriti kërkesën e tij për një vendimmarrje sa më të shpejtë nga ana e këtij institucioni, lidhur me

hetimin e thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve “Raimondo G.P” SHPK dhe “Li.Bo- Albania Branch“ SHPK.

II.6.7. Në datën 29.01.2024, është protokolluar në KPP me nr. 1257/8 prot., shkresa e Autoritetit të Konkurrencës me nr. 36/5 prot., datë 25.01.2024 me objekt: “Njoftim vendimi”, bashkëngjitur Vendimi nr. 1049, datë 16.01.2024 me objekt: “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo-Albania Branch SHPK dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo- Albania Branch SHPK”, me përmbajtje si vijon:

*Objekt: Mbyllja e procedurës së hetimit thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK, dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LLBO- Albania Branch SHPK.*

*Bazë ligjore: Neni 24, germa (d), neni 43, pika 5 dhe neni 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*

*Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:*

- *Raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;*

*Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK”;*

*Shpjegimet e paraqitura nga ndërmarrja Raimondo G.P SHPK nëpërmjet shkrësës nr. 36 prot., datë 10.01.2024 “Objeksione dhe shpjegime të “Raimondo GP SHPK” mbi konkluzionet në Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e Prokurimit Publik referuar protokollin Tuaj 373/29 del 22.12.20023”;*

*Seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 10.01.2024 me përfaqësues të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;*

*Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi seancën dëgjimore të zhvilluar nga ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;*

**VËREN SE:**

**I. Procedura e ndjekur**

*1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) nëpërmjet shkrësës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023) ka depozituar Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.BO- Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023”.*

*2. Në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 66 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 31, pika 3 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet Vendimit nr. 555/2023, ka vendosur:*

a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit “objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.

b) T'i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë KPP në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.

3.Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet LI.BO-Albania Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, vihet re se:

Operatori Raimondo G.P SHPK dhe operatori LI.BO-Albania Branch SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.

- Gjithashtu sipas të dhënave në ekstrakt, të cilat njoftohen vullnetarisht rezulton se adresa e e-mailit dhe numri i telefonit fiks është i njëjtë për të dyja ndërmarrjet.

- Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;

Të dy operatorët nuk kanë plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik” dhe Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

4.Sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK përdorin skenën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të singertë.

5.Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me Vendimin nr. 1000, datë 17.07.2023, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo

- Albania Branch SHPK, për periudhën kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023.

6.Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë: (i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca.

7. Në zbatim të Vendimit nr. 1000, datë 17.07.2023 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 373/3, datë 17.07.2023 “Autorizim inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë adresave të deklaruara në QKB të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK. Me

*paraqitjen e inspektorëve në adresën e përbashkët të dy subjekteve, u konstatua se në këtë adresë operonte ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK.*

*8.Ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK me objekt aktiviteti dhënien e asistencës sipërmarrësve dhe shoqërive në aktivitetin e menaxhimit të eksporteve në Shqipëri dhe jashtë vendit sidomos në ndërkombëtarizimin e bizneseve, është e kontraktuar nga ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHP për shërbime konsulence dhe kontabiliteti.*

*9.Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.*

*10. Ndërmarrja Raimondo G.P SHPK në datë 31.07.2023, dhe ndërmarrja Li.Bo - Albania Branch SHPK në datë 29.08.2023, janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku janë pyetur nga Sekretariati për 9ështjen objekt hetimi.*

*11.Gjatë inspektimit dhe nga takimet e realizuara pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka rezultuar se ndërmarrja Li.Bo në Itali është furnitor i ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK.*

*12.Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.*

*13.Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.*

*14.Për sa më sipër, periudhat hetimore të përcaktuara nga Autoriteti i Konkurrencës shtrihen në një afat kohor të gjatë, për të pasur kështu mundësinë e analizës të sa më shumë procedurave prokurimi ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Në rastin konkret, për arsye se ndërmarrja Raimondo G.P SHPK është regjistruar pranë QKB në datë 03.11.2021 dhe ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK është regjistruar pranë QKB në datë 20.10.2022, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar që periudha hetimore të jetë 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.*

*15.Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë: (i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca.*

16.Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor (Albanian Gas Service Company SHA).

## **II. Analiza e konkurrencës**

### **11.1 Tregu përkatës**

17.Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.

18.Procedurat e prokurimeve publike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.

19.Nga informacioni i marrë gjatë procedurës hetimore nga APP me shkresën m. 373/8 prot., datë 31.07.2023, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimeve publike të autoritetit kontraktor Albanian Gas Service Company SHA.

20.Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet shkresës nr. 373 prot., datë 06.07.2023, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ për procedurën e prokurimit me nr. Ref. 66587-04-19-2023, dhe objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA.

21.Nëpërmjet shkresës nr. 373/8 prot., datë 31.07.2023 të depozituar nga Agjencia e Prokurimit Publik pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë sjellë të gjithë procedurat e prokurimit publik ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Raimondo G,P SHPK dhe Li.Bo — Albania Branch SHPK kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimit të hapura nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Service Company SHA. Nga 8 procedura ku ka marrë pjesë Raimondo G.P SHPK, në dy prej tyre, ka marrë pjesë edhe ndërmarrja Li.Bo — Albania Branch SHPK.

22.Gjatë periudhës kohore 26 shtator 2022 — 26 tetor 2023, ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:

Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues Raimondo G.P SHPK.

ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti



kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA (shpallur fitues një tjetër pjesëmarrës në procedurën e tenderit).

23.Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu i prokurimit i veglave speciale dhe i pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG).

24.Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.

25.Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë

### **III.Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve**

26.Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD, “Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurimet Publike”.

27.Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Albanian Gas Services Company SHA në rolin e autoritetit kontraktues, nga APP dhe KPP si edhe dokumentacioni i gjetur gjatë procedurave të inspektimit në Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në zyrën e ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK.

28.Gjatë periudhës kohore 26 shtator 2022 — 26 tetor 2023, ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:

Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues Raimondo G.P SHPK.

ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues një tjetër operator ekonomik pjesëmarrës në tender.

29.Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin, si më poshtë:

- Li.Bo - Albania Branch	3.592.000 lekë, skualifikuar
- Raimondo G.P	3.640.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	3.640.000 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	3.801.680 lekë, kualifikuar

- *Ligus* 4.100.000 lekë, kualifikuar
- *Trinity Trade Company* 4.198.000 lekë, kualifikuar

30.Ndërmarrja *Li.Bo Albania Branch SHPK*, renditur e para, është skualifikuar nga procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, për arsye, si më poshtë vijon:

-Ka dorëzuar në *SPE* kopje të panoterizuara dhe pa vulë apostile të faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane *LI.BO SRL*.

-E njëjta gjë konstatohet edhe në *Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015*.

-Nuk plotëson kriterin për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

31.Ndërmarrjet *Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK* dhe *Raimondo G.P SHPK* kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja *Prime Advisory Albania SHPK*.

(i) *Ndërmarrja Raimondo G.P* ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen *Prime Advisory Albania SHPK*, ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes *Raimondo G.P SHPK*, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj; (ii) Për ndërmarrjen *Li.Bo - Albania Branch SHPK*, *Prime Advisory Albania SHPK* ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se *Li.Bo - Albania Branch SHPK*, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë *Prime Advisory Albania SHPK*.

32.Faktet e mësipërme përbëjnë dhe elementin kryesor mbi të cilin ngrihet dyshimi se ndërmarrjet mund të përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord që njëri nga konkurrentët të paraqesë një ofertë e cila përmban terma specifike të cilat janë të papranueshme nga autoriteti kontraktues.

33.Gjatë inspektimit, rezultoi se ndërmarrjet *Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK* dhe *Raimondo G.P SHPK* kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja *Prime Advisory Albania SHPK*. Kjo ndërmarrje ka për objekt veprimtarie dhënien e asistencës për sipërmarrës dhe shoqëri në aktivitetin e tyre dhe ndërmarrjet *Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK* dhe *Raimondo G.P SHPK* janë klientë të saj.

34.Ndërmarrja *Raimondo G.P* ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen *Prime Advisory Albania SHPK* ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes *Raimondo G.P SHPK*, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj.

35.Për ndërmarrjen *Li.Bo - Albania Branch SHPK*, *Prime Advisory Albania SHPK* ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se, *Li.Bo - Albania Branch SHPK*, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë *Prime Advisory Albania SHPK*.

36. Nëpërmjet shkresës nr. 373/13 prot., datë 28.08.2023 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës, dërguar nga ndërmarrja *AGSCo SHA*), grupi i punës ka verifikuar *DST* që ka dërguar secili operator ekonomik që ka marrë pjesë në procedurën me referencë REF: 66587-04-19-2023. Të dyja ndërmarrjet kanë nga 29 dokumente secila, dokumente që kanë shërbyer për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Nga verifikimi i tyre rezultojnë me disa elementë të ngjashëm:

- *Lista e çmimeve të artikujve.*
- *Formulari i Ofertës.*

- Dy ekstrakte QKB për secilën ndërmarrje, të cilat janë printuar të dyja në të njëjtën datë por në orare të ndryshme.

- Tabelat që ndërmarrjet kanë përdorur për të ofertuar produktet janë të ngjashme, tabela e ndërmarrjes Li.Bo përkatësisht e titulluar “CIPS & DCVG table for tender” dhe tabela e ndërmarrjes Raimondo e titulluar “CIPS & DCVG table for tender”.

- Për noterizimin e Certifikatës ISO, të dy ndërmarrjet kanë vajtur tek e njëjta notere, Belinda V. Celaj, por në data të ndryshme.

37.Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2- Vegla Speciale”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin si më poshtë:

- Raimondo G.P	3.984.750 lekë, kualifikuar
- AZ Trading	3.802.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	4.297.530 lekë, kualifikuar
- Vibtis	4.561.200 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	4.873.470 lekë, kualifikuar
- Li.Bo - Albania Branch	3.974.000 lekë, kualifikuar

38.Nëpërmjet shkresës nr. 373/13 prot., datë 28.08.2023 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës, dërguar nga ndërmarrja AGSCo SHA), grupi i punës ka verifikuar DST që ka dërguar secili operator ekonomik që ka marrë pjesë në procedurën me referencë REF: 66646-04-19-2023. Ndërmarrja Li.Bo Albania Branch ka bërë pjesë të procedurës së tenderit 26 dokumente ndërsa ndërmarrja Raimondo GP ka patur 23 dokumente që kanë shërbyer për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Nga verifikimi i tyre rezultojnë me disa elementë të ngjashëm:

i. Formulari i Ofertës: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë të njëjtin gabim gramatikor në fillimin e paragrafit të dytë të Formularit të Ofertës, ku të dyjave i mungon e njëjta shenjë pikësimi dhe gjithashtu formatimi, fonti, stili dhe madhësia e shkrimit janë të njëjta.

ii. Lista e çmimeve të artikujve: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë të njëjtin formatim, fonti, stili dhe madhësia e shkrimit janë të njëjta .

iii. Sigurimi i Ofertës: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo e kanë bërë sigurimin e ofertës te ndërmarrja Sigma Inteialbanian dhe numri serial i policave është i njëpasnjëshëm, përkatësisht për Raimondo GP nr. i policës është 3914 dhe për Li.Bo nr. i policës është 3915.

iv. Kontratë Shërbimi: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë lidhur kontratë shërbimi për sistemin devPos me të njëjtën ndërmarrje Image & Communication Development SHPK.

Deklaratë e Energjisë Elektrike: Subjekti Prime Advisory Albania SHPK ka deklaruar për të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo në të njëjtën datë 01.03.2023, se ato kanë selinë qendrore dokumentare pranë zyrës së tij dhe për këtë arsye për të plotësuar Kriteret e Përgjithshme të tenderit deklaroi se Prime Advisory Albania ka kryer të gjitha pagesat kundrejt FSHU.

vi. Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë depozituar Shtojcën 6, e cila është e njëjtë për të dyja ndërmarrjet.

vii. Formulari i Specifikimeve Teknike: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë depozituar Shtojcën 5, të cilat janë të njëjta.

39.Nëpërmjet informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit të thelluar nga ndërmarrja Raimondo GP SHPK vihet re se flitet shpesh edhe në emër të ndërmarrjes Li.Bo Branch SHPK duke nënkuptuar një lloj dakordësie mes dy palëve, e cila në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës në të shkuarën ose në të ardhmen.

40.Në procedurën e hapur me objekt “Loti 2- Blerje vegla speciale”, asnjë nga ndërmarrjet në hetim nuk është shpallur fituese nga autoriteti kontraktor dhe si rrjedhojë sjellja e dy ndërmarrjeve nuk ka sjellë pasoja në konkurrencë në tregun e prokurimeve publike. Ndërsa procedura e hapur me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, është ndërprerë për shkak të ankesës të pranuar nga KPP, dhe si rrjedhojë sjellja e dy ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, nuk ka arritur të finalizohet duke mos u shpallur fitues asnjëri prej tyre.

41.Në vijim të konstatimeve nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me:

i. Ndërmarrjet Rajmondo GP SHPK dhe Li.Bo Albania Branch SHPK kanë të njëjtën seli ligjore, të njëjtën adresë e-maili dhe numër telefoni.

Lidhur me këtë konstatim, gjatë seancës dëgjimore është shpjeguar se pasja e një selie ligjore dhe një adrese e-mail dhe numër telefoni ka ardhur si pasojë e kontraktimit të ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK për shërbimet e konsulencës dhe kontabilitetit. Ndërmarrjet kanë shpjeguar se janë lënë kontaktet e Prime Advisory për shkak se komunikimet duhet të ishin në gjuhën shqipe dhe përfaqësuesit e ndërmarrjeve nuk e njohin gjuhën shqipe. Vetë Prime Advisory Albania SHPK kryen shërbimet e konsulencës dhe kontabilitetit për disa ndërmarrje të huaja.

ii. Ndërmarrjet Rajmondo GP SHPK dhe Li.Bo Albania Branch SHPK kanë disa dokumente që rezultojnë me elementë të ngjashëm.

Lidhur me këtë konstatim, ndërmarrjet kanë shpjeguar gjatë seancës dëgjimore se përkthimet kanë kërkuar ndihmën e Prime Advisory Albania, noterizimet janë kryer tek noteri i ndërmarrjes ku Prime Advisory referohet për procedura të ndryshme dhe dokumentacioni nga të tretë si sigurimi i ofertës, ekstraktet e QKB, etj., janë gjeneruar po nga ndërmarrja Prime Advisory Albania. Por dokumentacioni i lidhur me shumën e ofertuar është bërë në mënyrë të pavarur nga secila ndërmarrje.

iii. Informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit të thelluar nga ndërmarrja Raimondo GP SHPK, e cila flet dhe në emër të ndërmarrjes Li.Bo Branch SHPK.

Lidhur me këtë konstatim, ndërmarrja Raimondo GP SHPK në seancë dëgjimore ka shpjeguar se nuk ka folur në emër të Li.Bo Branch SHPK, por vetëm i është referuar si një ndërmarrje e lidhur në këtë proces hetimor.

42.Sa më sipër, për shkak të mënyrës se si ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK kryejnë aktivitetin në Shqipëri, duke qenë se Li.Bo ka qenë furnitor i Raimondo G.P SHPK si dhe gjithashtu për shkak se gjatë procedurës së inspektimit nuk janë gjetur evidenca direkte, për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e prokurimit me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për

*kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo — ALBANIA të ketë shkelje të nenit 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121/2003.*

**PËR KËTO ARSYE:**

*Komisioni i Konkurrencës, bazuar në, nenin 24, germa (d), neni 43, pika 5 dhe nenin 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,*

**VENDOSI:**

*I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.*

*II. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që brenda 90 ditëve të realizojnë ndryshimet përkatëse për të kryer një aktivitet të pavarur nga njëri tjetri dhe konkretisht:*

*i. Të ndryshojnë selinë e ushtrimit të aktivitetit;*

*ii. Të kenë adresa e-mail dhe numra telefoni të pavarur nga njëri tjetri;*

*III. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që kur marrin pjesë individualisht në procedurat e prokurimit publik të ofertojnë në mënyrë të pavarur.*

*IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik,**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe institucioneve të tjera,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK, për skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e KVO-së, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 14.06.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1250/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 26/9 prot., datë 12.06.2023, me objekt: “Dërgohen vendimet e shqyrtimit të ankesave të OE “Trak Mar” SHPH dhe OE “Li.Bo – Albania Branch” SHPK”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së “Li.Bo” SHPK nr. 26/7 prot., datë 01.06.2023. Sipas Vendimit të KSHA-së, mbi shqyrtimin e ankesës së “Li.Bo” SHPK nr. 26/7 prot., datë 01.06.2023, rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik

“Li.Bo” SHPK. Konkretisht janë pranuar pretendimet e ankimuesit në lidhje me pikën 2 të ankesës, pasi rezulton, se KSHA ka vlerësuar, se pretendimet e ankimuesit qëndrojnë për këtë pikë dhe merren parasysh nga komisioni.

III.1.2. Referuar ankesës së paraqitur në datën 31.05.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga ana e operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK, rezulton, se pretendimet në pikën e dytë të ankesës janë shprehimisht si vijon:

*2. Per sa i perket arsyes se refuzimit “2- Certifikata për sistemimin e Menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 e cila nuk është noterizuar kopja me origjinalin”, ashtu sikurse e theksuam edhe në pikën 1 më sipër, bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në formularin e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit Shtojca 8 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentet e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Certifikatat ISO janë të aksesueshme online në ueb: <https://ëëë.rina.org/en> në seksionin lista e certifikatave, në fund, duke shkruar numrin e certifikatës. Vlefshmëria e tyre mund të shihet në kohë reale. Në përputhje me marrëveshjet e njohjes reciproke të organeve akredituese, në rastin konkret ACRREDIA IAF, anëtarë të marrëveshjeve të Njohjes së ndërsjellë të EA, IAF dhe ILAC, certifikata elektronike që mund të shkarkohet drejtpërdrejt nga faqja, është gjithashtu plotësisht e vlefshme në territori shqiptar.*

*Shiko bashkëlidhur Aneks 7: Certifikata ISO 9001:2015*

*Për sa kohë kriteret e tenderit ishin që: Dokumentet e tenderit duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomikë online ishte i skanuar direkt nga origjinali, duke hedhur poshtë kërkesën tuaj “të njehsuara me origjinalin”.*

*Pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tone nuk qëndron dhe kërkojme të rishikohet.*

III.1.2. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Li.Bo Albania Branch” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK se: *“Per plotesimin e kriterit 2.2.1 ne shtojcen 7 per kontratat e ngjashme OE ka dorezuar ne SPE kopje te faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 ne emer te kompanise meme italiane LI.BO SRL, te cilat nuk jane noterizuar kopjet me origjinalin por vetem noterizimi i perkthimit, si dhe mungon vula apostile”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1 e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës për eksperiencat e mëparshme, si më poshtë vijon:

**2.3.1.** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*

- a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose*
- b) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.2.2. Në shtojcën 7, “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit, në tre paragrafët e fundit, rezulton se parashikohet si vijon:

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.*

*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

III.2.3. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

III.2.5. Në nenin 62, pika 1 “Kompetencat e noterit” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” parashikohet se: “i) vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara”.

Në nenin 129 “Vërtetimi i njësisë me origjinalin”, parashikohet se: “1. Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre.

2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin.

3. Kur dokumenti i paraqitur ka shënime, korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, noteri bën njësimin dhe i pasqyron ato në vërtetim. Në vërtetim pasqyrohet edhe nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur kjo duket qartë nga kopja e dokumentit origjinal.

4. Në rastin e kopjeve të shkurtuara, noteri sqaron nëse pjesët e hequra kanë ndonjë lidhje për pjesët e paraqitura të aktit.

5. Në rastin kur dokumenti është në gjuhë të huaj noteri bën vërtetimin e njësisë me origjinalin, duke kërkuar ndihmën e një përkthyesi, ose duke e bërë vetë kryesisht, sipas parashikimeve të nenit 100 të këtij ligji”

III.2.6 Në ligjin Nr.9060, datë 08.05.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventen për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”” është përcaktuar:

Neni 1, Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë. Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare: a) dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretaritë e gjykatave dhe zyrat përmbartimore; b) dokumentet administrative; c) aktet noteriale; d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë se firmave.

Neni 3, Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i firmës, cilësia në të cilën ka vepruar personi që firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai bart, formaliteti i vetëm që mund të kërkohet është paraqitja e një çertifikate, të përshkruar në nenin 4, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin.

Neni 4, Çertifikata e përmendur në nenin 3 paragrafi i parë vendoset për se gjati në një qoshe të dokumentit, sipas modelit bashkëngjitur kësaj Konvente. Megjithëse ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon dhe në një gjuhë të dytë, titulli, çertifikata, duhet të jenë në gjuhën frënge "Apostille" (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961).

III.2.7. Lidhur me arsyen e skualifikimit ankimesi pretendon si vijon: I. Per sa i perket arsyes se refuzimit “1-. Për plotësimin e kriterit 2.2.1 në shtojcën 7 për kontratat e ngjashme OE ka dorëzuar në SPE kopje të faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane Li.Bo srl, të cilat nuk janë noterizuar kopjet me origjinalin por vetëm noterizimet e përkthimit, si dhe mungon vula apostile”



*Për sa i përket kërkesës tuaj se duhet të paraqitej noterizimi i kopjes me origjinalin, ju vëmë në dijeni se faturat janë skanuar nga origjinali dhe nuk ka patur nevojë për njësim të fotokopjes së bërë nga origjinali. Për ligjshmërinë e këtij veprimi është shprehur edhe në DST ku thuhet se Bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në formularin e kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit Shtojca 8 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentet e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Pra, për sa kohë kriteret e tenderit ishin që: Dokumentet e tenderit duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, automatikisht bie poshtë kërkesa juaj “të njësuara me origjinalin” pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tonë nuk qëndron dhe kërkojmë të rishikohet.*

*Për sa i përket kërkesës tuaj për apostilim të faturave, ju informojmë se referuar konventës së Hagës 5 Tetor 1961, ku Italia dhe Shqipëria janë shtete anëtare të saj, lista e dokumenteve që duhen apostiluar janë vetëm ato dokumente publike të lëshuara nga administrata shtetërore e Italisë dhe jo dokumentet private të lëshuara nga shoqëri apo individë privat që operojnë në treg të pavarur nga Shteti.*

*Referuar konventës së Hagës 5 Tetor 1961, Neni 1 i tij citon: (Shiko bashkëlidhur Aneks 1: Konventa që Shfiron kërkesën e Legalizimit të Dokumenteve Publike Te Huaja (përfunduar më 5 TETOR 1961)*

*Kjo konventë do të zbatohet për dokumentet publike që janë ekzekutuar në territorin e një Shteti Kontraktues dhe që duhet të dorëzohen në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues. Për qëllime të kësaj Konvente, dokumentet e mëposhtme konsiderohen si dokumente publike:*

*a) dokumente që vijnë nga një autoritet ose një zyrtar i lidhur me gjykatat ose tribunatet e shtetit, duke përfshirë ato që rrjedhin nga një prokuror publik, një nëpunës i një gjykate ose një shërbyes procesi (huissier de justice);*

*b) dokumentet administrative;*

*c) aktet noteriale;*

*d) certifikatat zyrtare që vendosen në dokumente të nënshkruara nga persona në cilësinë e tyre private, si p.sh. Certifikatat zyrtare që regjistrojnë regjistrimin e një dokumenti ose faktin që ai ka ekzistuar në një datë të caktuar dhe vërtetimet zyrtare dhe noteriale të nënshkrimeve. Megjithatë, kjo konventë nuk do të zbatohet:*

*a) për dokumentet e ekzekutuara nga agjentë diplomatikë ose konsullorë;*

*b) për dokumentet administrative që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me operacionet tregtare ose doganore.*

*Referuar faqes zyrtare të zyrës përkatëse, pranë Ministrisë së Jashtme në Itali, që merret me apostilimet theksohet si më poshtë:*

*Një apostil mund të kërkohet vetëm për dokumente dhe akte publike. Kjo do të thotë që individët privatë dhe shoqëritë tregtare janë të përjashtuar, (Shiko ueb: <https://www.esteri.it/it/servizi-consolari-e-visti/italiani-all-estero/traduzione-e-legalizzazione-documenti/legalizzazione-documenti>).*

*Pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tonë nuk qëndron dhe kërkojmë të rishikohet;*

*Një sqarim i mëtejshëm: Dega Li.Bo Albania Branch, është identifikuar si seli (degë) e përhershme e Li.Bo.srl.*

*Mbi bazën e nenit 162 të TUIR (Ligji i Konsoliduar i Tatimit mbi të Ardhurat (TUIR) (Dekreti Presidencial i 22 dhjetorit 1986, nr. 917) shprehja seli e përhershme përcakton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit shoqëria jorezidente ushtron të gjitha ose pjesë e veprimtarisë së tij në territorin e shtetit.*

*<https://def.finanze.it/doctribfrontend/getarticolodetailfromresultlist.do?Id={8052C201-DF5B-4248-AD74-BCA56A4EAF7}&codiceordinamento=200016200000000&idattonormativo={31D6 94E8-4398-4030-873B-FEAF5A6647F9}>*

*Prandaj, selia e përhershme nuk është mbajtëse e subjektivitetit juridik autonom të ndryshëm nga shoqëria mëmë: është e njëjta shoqëri jorezidente që operon në një shtet të huaj nëpërmjet një selie të përhershme, prandaj nga kjo fiton kërkesat ekonomike, teknike dhe të certifikimit.*

*Bashkëlidhur do të gjeni materialet referuese:*

- Aneks 1: Konventa që shifron kërkesën e legalizimit të dokumenteve publike të huaja*
- Aneks 2: Rregullorja (BE) 2016 /1191 e cila promovon lëvizjen e lirë të qytetarëve duke thjeshtuar kërkesat për paraqitjen e disa dokumenteve.*
- Aneks 3: Legalizimi i dokumenteve nëpërmjet vendeve anetare ne konventën e Hagës.*
- Aneks 4: përkthimi dhe : Legalizimi i dokumenteve nepermjet vendeve anetare ne konventën e Hagës.*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë me dokumentacionin e tyre, përveç se të vërtetojnë se disponojnë kapacitetet e nevojshme ligjore, financiare dhe teknike për realizimin e kontratës, duhet të paraqesin dokumentacionin administrativo-ligjor që vërteton këto kapacitete, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në të kundërt dokumentacioni i paraqitur jo në formën e kërkuar është i pavlefshëm.

III.2.9. Rezulton, se operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi në gjuhën italiane të përkthyer në gjuhën shqipe fatura me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane Li.Bo srl. Përkthimi, sikundër rezulton edhe në dokumentin vërtetim - përkthimi të noteres, është kryer nga një përkthyes i licencuar. Në dokumentin vërtetim - përkthimi të noteres nr. 356 rep., datë 26.04.2023, bashkëngjitur aktit të përkthimit të faturave, gjendet nënshkrimi dhe vula e përkthyesit zyrtar të njohur nga noteri.

Në Manualin nr. 1, datë 21.01.2021 “Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, faqja 19 të tij, ndër të tjera, thuhet se: “*Para se të filloni me ngarkimin e dokumentave, duhet të siguroheni që të gjithë dokumentat të jenë të konvertuara në mënyrë elektronike në formatin .pdf në kompjuterin tuaj. Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar. Versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në Sistemin e Prokurimit*

*Elektronik, për një procedurë prokurimi konkrete është i barazvlefshëm me dokumentin origjinal, ose kopjen e noterizuar.”*

Në këto kushte, për sa kohë dokumenti i ngarkuar në SPE është skanuar nga origjinali dhe duke qenë se versioni i skanuar i dokumenteve, pasi hidhet në sistemin elektronik të prokurimit për një procedurë konkrete, është i barazvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë dokumentacionin origjinal të faturave të sipërcituara për të bërë krahasimin me dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe të marrë vendime në bazë të konstatimeve, në përputhje me përcaktimet nënligjore, të cituara më lart.

III.2.10. Lidhur me konstatimin e autoritetit kontraktor, se për faturat me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane LI.BO SRL, mungon vula apostile, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se procedura e legalizimit është e detyrueshme për të gjitha dokumentet e lëshuara nga administrata shqiptare, që do të përdoren pranë administratave të shteteve të tjera, apo ato të lëshuara nga administrata e një shteti tjetër, që do të përdoren pranë administratës shqiptare. Ajo konsiston në njohjen formale nga punonjësit konsullorë, të vulës dhe nënshkrimit të autoritetit që e ka lëshuar dokumentin. Kjo e bën dokumentin njësoj të vlefshëm, nga pikëpamja ligjore, edhe jashtë territorit të vendit ku është lëshuar.

Shqipëria, sikundër edhe Italia është anëtare e Konventës së Hagës “Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja” të 5 tetorit 1961, që do të thotë se dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore. Në bazë të kësaj Konvente, dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren direkt në institucionin përkatës të vendit pritës.

Gjithashtu, sipas Konventës së Hagës 5 Tetor 1961, dokumentet që duhen legalizuar janë vetëm ato dokumente publike të lëshuara nga administrata shtetërore dhe jo dokumentet private të lëshuara nga shoqëri apo individë privat që operojnë në treg të pavarur nga Shteti.

Sa më sipër, faturat me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane Li.Bo srl, nuk janë dokumente publike të lëshuara nga administrata shtetërore e Italisë, por janë dokumente private dhe si të tilla nuk i nënshtrohen procesit të legalizimit nga përfaqësitë diplomatike e konsullore.

KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë se, operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor, kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal të

parashikuara në nenin 82, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për më tepër, që autoriteti kontraktor mund të ishte drejtuar për informacion më të detajuar organeve kompetente siç është Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma e Noterisë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK se: *“Nuk ploteson kriterin 2.1.1 në shtojcën 7 për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument nga administrata tatimore për xhiron ose vetedeklarim nëse ky dokument nuk lëshohet nga vendi i origjinës së kompanisë me LI.BO SRL, në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19/05/2021, Nenin 26 ku parashikohet shprehimisht se: Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në shtojcën 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.** *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

III.3.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se:

*“Sistemi Italian, ndryshe nga ai Shqiptar nuk konfirmon dorëzimin e tyre, por vetëm depozitohen në organet tatimore në format elektronik. Prandaj bilancet e shoqërisë janë dërguar në atë format. Dorëzimi i bilanceve nuk mund të konsiderohet si i paparaqitur nga ana jonë, pasi dorëzimi i tyre në formatin elektronik provon dhenien e informacionit, pra dorëzimi i bilanceve, për tre vitet e fundit, duhet të interpretohet nga ana juaj si vetedeklarim nga operatori ekonomik, ashtu sikurse e keni të shprehur qartë edhe në VKM me nr. 285 datë 19/05/2021. Neni 26, “Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. Për sa kohë informacioni i kërkuar nga ana juaj është i qartë dhe i dukshëm në të dhënat e Bilanceve të depozituara nga ana jonë, prandaj dalim në konkluzion se dorëzimi i bilanceve do të konsiderohet si vetëdeklarim nga ana jonë për xhirot vjetore, pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tonë nuk qëndron dhe kërkojmë të rishikohet. Deklarata e posedimit të kërkesave të xhiros për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është përfshirë në Aneksin 8, Deklarata e posedimit të kërkesave të përgjithshme të tenderit. Shiko bashkëlidhur - shtojcën 5: Shtojca 8*

*Roberto deklaratën e përgjithshme të posedimit të kushteve të kërkuara për konfirmim të mëtejshëm, në deklaratë kemi nxjerrë në pah vlerat e xhiros së Li.Bo për trevjecarin e fundit 19-20-21. - Aneks 6: Pasqyra e qarkullimit të tre viteve të fundit për Li.Bo. Srl 4 .Per sa i perket arsyes se refuzimit “Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe do të konsiderohet i paparaqitur. Nuk është e drejtë të refuzoni ofertën tonë me këtë arsye, pasi informacioni në lidhje me xhiron vjetore ju është vënë në dijeni nga bilancet e Li.bo, te cilat mund të interpretohet edhe si vetëdeklarim, pasi ato janë akte të prodhuara nga shoqëria bazuar nga të dhënat financiare të tyre, pra kjo arsye e refuzimit të ofertës tone nuk qendron dhe kërkojmë të rishikohet. Duke iu referuar artit. 92 të LPP-së... “Administrata ose stacioni kontraktues, kur e sheh të arsyeshme, kërkon nga ofertuesit sqarime në lidhje me ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e këtyre ofertave në mënyrën më korrekte të mundshme. Pa cenuar dispozitat e këtij ligji, mendojmë se duhet të kishim marrë një kërkesë për sqarim përpara parashikimit të përjashtimit nga tenderi sepse do të kishim dhënë informacionin dhe mjetet zyrtare për të verifikuar që arsye të tilla ishin të pabazuara.”,*

Rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ka refuzuar këto pretendime, duke argumentuar si vijon:

*“Në lidhje me [pretendimin e ngritur nga ankuesi për pikën 3 dhe 4, KSHA arsyeton se [...] Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 82, pika 4 specifikohet se: “4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.” Dhe në VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 6 neni 26 specifikohet se “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.” Operatori ekonomik “LiBo -Albania Branch” SHPK nuk ka paraqitur në SPE vetëdeklarim (sikurse dhe ka pranuar), për të vërtetuar se shteti Italian nuk e lëshon dokumentacionin e kërkuar dhe si rrjedhojë do të paraqiste dokumente të tjera provuese sikurse parashikohet nga legjislacioni në fuqi.”*

III.3.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, ( S.P.E ), Komisioni konstaton, se në funksion të plotësimit të kriterit 2.2.1 të mësipërm, operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK ka dorëzuar në SPE Shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të plotësuar nga Carlo Francesco Renato Bocca, drejtor i Li.Bo srl., kompania mëmë e degës LiBo -Albania Branch, si dhe Shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në të cilën z. Roberto Bocca, në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik LiBo - Albania Branch, deklaroi emrin e subjektit LiBo srl, mëmë e degës Li.Bo Albania Branch, në kapacitetin e të cilës do të mbështetet për sa i përket treguesit për qarkullimin e shoqërisë mëmë dhe pasqyrat financiare 2019, 2020 dhe 2021, të po kësaj shoqërie, bashkëngjitur formularit, pasqyrat financiare për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të kompanisë Li.Bo srl. Referuar ekstraktit të regjistrit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rezulton, se operatori ekonomik “Li. Bo Albania Branch” SHPK, është regjistruar si

shoqëri tregtare në datën 20/10/2022 , “Forma Ligjore” e të cilit është “Dege e shoqërisë së huaj” dhe në pikën 13 të ekstraktit “13.Të dhënat e shoqërisë së huaj”, emri i shoqërisë së huaj rezulton “LI.BO S.R.L”.

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet*

*kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

III.3.6. Në nenin 82, pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik thuhet se:

*“4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.”*

Në nenin 92, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

III.3.7. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:*

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].*

*Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes*

*financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

Në nenin 26, pika 6 dhe 7 të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: 6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.3.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në këtë kontekst, rezulton, se operatori ekonomik “Li.Bo – Albania Branch” SHPK ka dorëzuar në SPE pasqyrat financiare të kompanisë Li.Bo. srl për vitet 2019, 2020 dhe 2021, si dhe në formularin e vetëdeklarimit, në të cilin administratori i shoqërisë Li. Bo Albania Branch SHPK deklaron se do të mbështetet në qarkullimin e shoqërisë mëmë, dhe pasqyrat financiare të saj (Li.Bo. srl) për plotësimin e kapaciteteve ekonomike dhe financiare të parashikuara në dokumentat e tenderit, përfshirë këtu bilancet dhe xhiron. Gjithashtu, ankimuesi ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku rezulton, se operatori ekonomik “Li. Bo Albania Branch” SHPK është regjistruar si shoqëri tregtare në datën 20/10/2022, “Forma Ligjore” e të cilit është “Dege e shoqërisë së huaj” dhe në pikën 13 të ekstraktit “13.Të dhënat e shoqërisë së huaj”, emri i shoqërisë së huaj rezulton “LI.Bo S.R.L”.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe



nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Në kushtet kur operatori ekonomik ankimes ka dhënë indicie për autoritetin kontraktor, ky i fundit, referuar nenit 92 të LPP-së, ka pasur detyrimin procedural të kryejë verifikimet përkatëse, apo të kërkojë sqarime nga ankimesi, gje për të cilin rezulton, se AK nuk i ka kryer këto verifikime, duke e marrë të mirëqenë që shoqëria “Li. Bo Albania Branch” SHPK, nuk plotëson kapacitetin ekonomik e finaciar lidhur me xhiron e kërkuar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Li. Bo Albania Branch” SHPK qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “TrakMar” SHPK se: “[...] Referuar Ekstraktit Historik nga QKB të “Raimondo G.P” SHPK me NUIS: M12304002Q dhe dokumenteve bashkëngjitur bëhet fjalë për një kompani të krijuar në datën 03.11.2021 me zyrë në adresën: Durrës, Rruga “Grigor Durrsaku”, EGT CENTER, Zona Kadastrale 8514, Nr. pasurie 3/319-N18. Kjo është dhe adresa e vetme e kompanisë pasi tek Ekstrakti Historik, pika 3: “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit “, është bosh, pa asnjë të dhënë të plotësuar/deklaruar.

Duke vazhduar kërkimin për Raimondo G.P, i referohemi kompanisë Li.BO-Albania Branch me NUIS: M22220501B, një kompani e themeluar me datë 20.10.2022.

Ajo që na bën përshtypje dhe që ngremë dyshime janë 2 (dy) elementë:

1. Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch kanë të njëjtën adresë: Durrës, Lagjia Nr.3, Sheshi Liria, tek EGT CENTER, Ap 18, ndodhur ne Zonën Kadastrale 8514 me Numër. pasurie 3/319-N18, Kati 2. (Referuar ekstrakteve bashkëngjitur).
2. Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch kanë të njëjta të dhëna të njoftuara vullnetarisht: email: [arjana.mecaj@primeadvisory.eu](mailto:arjana.mecaj@primeadvisory.eu). Numër telefoni: 052901240.
3. Gjithashtu vëmë re se dokumenti bashkëngjitur në ekstraktin e QKB të Raimondo G.P me titull: “Depozitimi i pasqyrave financiare” është i përgatitur nga [erisa.rustemi@primeadvisory.eu](mailto:erisa.rustemi@primeadvisory.eu), e cila është e deklaruar gjithashtu dhe tek ekstrakti i Li.BO-Albania Branch.

Duket qartë se KVO nuk ka bërë verifikimet përkatëse të sipër përmendura sipas të cilave duhet të kishte skualifikuar të 2 (dy) operatorët ekonomikë pjesëmarrës (Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch) në përputhje me ligjet në fuqi.

Si ka mundësi që ofertat e paraqitura të jenë të pavarura duke qenë se këto subjekte janë bashkuar në të njëjtën adresë në të njëjtën periudhë, kanë si administrator persona të së njëjtës nënshtetësi, ndajnë ekzaktesisht të njëjtin ambient, personi i kontaktit ( [arjana.mecaj@primeadvisory.eu](mailto:arjana.mecaj@primeadvisory.eu)) është i njëjtë, numër telefoni i kontaktit është i njëjtë dhe marrin pjesë në të njëjtat procedura prokurimi.

Për sa më sipër dyshimet tona janë të forta dhe konkrete mbi lidhjen që kanë këto dy kompani, duke mos plotësuar kriterin e vetëdeklarimit të shtojcës 8 të DST shkronja B: Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura dhe pikën C të shtojcës 8 të DST mbi

konfliktin e interesit, kanë cenuar ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 2, pika “c”, “ç”, “d”, “dh”, neni 3, pika 1, 2 dhe 3.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “TrakMar” SHPK rezulton, se ato lidhen me konstatime për shenja paralajmëuese mbi bashkëpunimin mes operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, për marrëveshje të ndaluar mes tyre në kuptim të ligjit.

III.4.2. Në nenin 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar parashikohet se: “Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre.

III.4.3. Neni 4 “Marrëveshjet e ndaluara” parashikon shprehimisht se: *Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave*

*Marrëveshjet që ndalohen, sipas pikës 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas neneve 5, 6 dhe 7, janë të pavlefshme.*

III.4.4. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II, Shkaqet e përjashtimit, gërma “B”, Deklarata, “Për dorëzimin e ofertave të pavarura”, në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt - ankimi kërkohet si vijon:

***Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura***

*Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:*

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.**

6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
  - a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
  - b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
  - a) *çmimet ;*
  - b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
  - c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
  - d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

Pra Deklarata për paraqitje oferte të pavarur në paragrafin e parë të saj parashikon shprehimisht, se ajo mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në Ligjin Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Gjithashtu, në pikën 2 të Deklaratës për paraqitje oferte të pavarur parashikohet se: “Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;”

III.4.5. Referuar pretendimeve të shoqërisë “TrakMar” SHPK, si dhe nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik në Ektraktet Historike të QKB për dy shoqëritë objekt ankimi, rezulton, se Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch kanë të njëjtën adresë; Raimondo G.P dhe Li.BO-Albania Branch kanë të njëjtat të dhëna të njoftuara vullnetarisht: email: [arjana.mecaj@primeadvizory.eu](mailto:arjana.mecaj@primeadvizory.eu), numër telefoni: 052901240 si dhe në ekstraktin e QKB të Raimondo G.P me titull: “Depozitimi i pasqyrave financiare”, është i përgatitur nga [erisa.rustemi@primeadvizory.eu](mailto:erisa.rustemi@primeadvizory.eu), e cila është e deklaruar gjithashtu dhe tek ekstrakti i Li.BO-Albania Branch. Në këto kushte, referuar *lex specialis*, kompetencat e hetimit administrativ në rast se ofertat e paraqitura nga ana e operatorëve ekonomikë “Raimondo G.P” SHPK dhe “Li.BO-Albania Branch” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, kanë elementë të marrëveshjes së ndaluar në kuptim të ligjit, janë kompetencë e Autoritetit të Konkurrencës. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II, Shkaqet e përjashtimit, gërma “B”, Deklarata, “Për dorëzimin e ofertave të pavarura” subjekti “Raimondo G.P” SHPK , ka pohuar se: 6.“ *Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent*

tjetër”. Në pikën 7, po këtu ankimuesi ka deklaruar se nuk është konsultuar, nuk ka komunikuar, nuk ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi, dhe më pas në pikat 8, 9 dhe 10 ka pohuar se: “8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me: a) çmimet;b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës”; “9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.” “10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart”.

Gjithashtu rezulton se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II, Shkaqet e përjashtimit, gërma “B”, Deklarata, “Për dorëzimin e ofertave të pavarura” subjekti “Li.Bo Albania Branch” SHPK , ka pohuar se 6.“ Ofertuesi deklaroi se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”. Në pikën 7, po këtu ankimuesi ka deklaruar se nuk është konsultuar, nuk ka komunikuar, nuk ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi, dhe më pas në pikat 8, 9 dhe 10 ka pohuar se: “8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me: a) çmimet;b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës”; “9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.” “10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart”.

III.4.6. Referuar Vendimit të KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së “Trak Mar” SHPK nr. 26/6 prot., datë 31.05.2023, rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke argumentuar si vijon:

“[...] Në procedurën ankimuese, të filluar me kërkesë të palës OE “TrakMar” SHPK, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë të fundit. Në mënyrë që të mbështesë pretendimet e saj, OE ankimues duhet t'i kishte bashkëlidhur kërkesës për fillimin e procedurës ankimuese dokumente ose fakte të ndryshme, të cilat mungojnë, sa i përket provueshmërisë së pretendimit mbi kualifikimin jo të drejtë të OE “Raimondo GP” SHPK.

OE “TrakMar” SHPK pjesëmarrës në procedurë, ankohet në lidhje me ofertën e operatorëve konkurrentë, pësha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të

*fundit është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që AK dhe struktura ad-hoc e ngritur prej tij për shqyrtimin e ankesës (KSHA), adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i AK ka qenë i gabuar, sipas ankimesit. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik.*

*KSHA nuk mund të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike.*

*Pavarësisht këtij fakti, në shërbim të transparencës dhe respektimit të një vendimmarrje të drejtë përtej çdo dyshimi, KSHA vlerësoi ankesën sa i përket këtij pretendimi bazuar në DT, kërkesat kualifikuese si dhe në vlerësimin e KVO.*

*Në kuadër të veprimeve të ndërmarra për sa i përket pretendimit të OE "TrakMar", KSHA ka dërguar një e-mail duke kërkuar informacion nga subjekti Prime Advisory Albania për lidhjen që ky subjekt ka me OE "Raimondo GP" SHPK dhe "LI.BO-ALBANIA BRANCH" SHPK.*

*Subjekti Prime Advisory Albania ka shpjeguar si më poshtë vijon:*

*"Subjektet tregtare "RAIMONDO GP" ShPK dhe "LI. BO-ALBANIA" ShPK, janë klientë të studios "Prime Advisory Albania" e cila kryen shërbime konsulence financiare, duke iu ofruar mbështetje të gjithë subjekteve tregtare me të cilat bashkepunon. Në këtë kuadër disa kliente të saj me administratore të huaj, duke përfshirë edhe subjektet e sipërpermdura, perdorin adresën tone elektronike dhe si seli qendrore, por jo operative, adresën ku është e vendosur si seli "Prime Advisory Albania", Lagjia nr.3, Sheshi "Liria", tek EGT Center, ap.18, ndodhur në ZK.8514 me nr. pasurie 3/319-N18, Kati 2, Durres".*

***Përfundimisht, KSHA e gjen të vlefshëm argumentimin e KVO-së për kualifikimin e OE Raimondo GP duke mos e marrë parasysh ankimin për këtë pjesë.***

***Mbi arsyet e mospranimit të ankesës së OE "TrakMar" shpk:***

*Në zbatim të nenit 81 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar citohet se:*

- 1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.*
- 2. Nderhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi,*
- 3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për nderhyrje në ofertë nga ana e operatoreve ekonomike ofertues.*

*Fakti që të dy operatorët ekonomikë kanë të njëjtën adresë apo të dhëna që njoftohen vullnetarisht, nuk janë të dhëna përcaktuese që janë i njëjti operator ekonomik.*

*Nga ana e KSHA, u kryen veprimet verifikuese si më poshtë vijon:*

U verifikua adresa <https://ëëë.primeadvisory.eu/en/contacts/> e Prime Advisory, ku në objektin e aktivitetit përshkruhet: “Te jape asistence sipërmarrësve dhe shoqerive ne aktivitetin e menaxhimit te exporteve ne Shqiperi dhe jashte vendit dhe ne menyre te vecante cdolloj forme konsulence per nderkombetarizimin e bizneseve, perfshire aktivitetet funksionale te lidhura me hapjen e nje aktiviteti tregtar ne cdo vend te Botes. Aktiviteti i gjetjes se partnereve tregtar ose industriale, klienteve, agjenteve ose shperndaresve te autorizuar ose jo. Realizimi i studimeve te fizibilitetit ne fushen e nderkombetarizimit te biznesit perfshire edhe pergatitjen e Biznes Planeve, planeve industriale dhe studime mbi planifikimin fiskal nderkombetar. Organizimi i takimeve B2B midis operatoreve tregtare te vendeve te ndryshme. Konsulence ne realizimin e selive jashte vendit. Konsulence ne fushen e blerjes se shoqerive te huaja dhe M&A nderkombetare. Organizimin e transfertave te biznesit (transferta pune) jashte vendit. Kerkimi dhe seleksionimi i personelit per tu punesuar ne selite e shoqerive ne Shqiperi dhe jashte vendit. Konsulence fiskale, organizative dhe doganore. Aktivitetin e zhvillimit te software-ve per llogari te vet apo te te treteve”.

Sa më sipër konfirmohet edhe në Regjistrin Tregtar në saj të ekstraktit të regjistrimit pranë QKB për subjektin PRIME ADVISORY ALBANIA, me NUIS L81613507G, përfaqësuar nga Administratorët dhe me adresë: Durrës, Lagjja nr.3, Sheshi "Liria", tek EGT Center, ap.18 ndodhur ne ZK.8514 me nr. pasurie 3/319-Nl8, Kati 2, ku për të dhënat e subjektit për Degët ose zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja të OE “LI.BO - ALBANIA Branch” ShPK rezulton se përfaqësues ligjor i degës/zyrës së përfaqësimit është Z.Roberto Bocca dhe Ekstraktit Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” të OE "Raimondo G.P” ShPK rezulton se administrator është Znj. Lucia Raimondo.

Si rrjedhojë konstalohet, se OE "Raimondo GP" dhe OK "Li. Bo-Albania" kanë të njëjtën adresë për efekt të njoftimit pranë shoqërisë e cila ka kryer veprimet procedurale për regjistrimin e biznesit etj. Aktivitet ky që ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk krijon apo të krijojë në të ardhmen kushte për konflikt interesi në një ofertë të bashkërenduar. Shtuar këtu, fakti që pikërisht "Li.Bo-Albania" është skualifikuar nga KVO.

Duke iu referuar nenit të VKM së sipërcituar si dhe ekstrakteve të OE, nuk rezulton i njëjti ortak apo administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit për këtë pikë nuk qendron dhe nuk merret parasysh nga komisioni i shqyrtimit të ankesës.

Në këto kushte, bazuar në sa kemi trajtuar më sipër, komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nga ankuesi nuk qëndrojnë ndaj vendosëm të mos pranojmë ankesën e paraqitur nga OE “TRAK MAR” ShPK nr.26/6 prot, date 31.05.2023, me REF-66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” dhe fond limit prej 4,854,422 ((katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e dy) lekë pa TVSh.”

III.4.8. Në nenin 66, pika 1 dhe 3 “Çështjet paraprake” të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “ 1. Nëse organi

publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”

“3. Nëse zgjidhja e çështjes paraprake kërkon iniciativën kryesisht të organit tjetër publik, organi kompetent për zhvillimin e procedurës kërkon fillimin e procedurës nga organi tjetër.”

III.4.9. Në nenin 31, pika 3 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, thuhet shprehimisht:

“Nëse Komisioni i Prokurimit Publik, gjatë shqyrtimit të çështjes, për çështje specifike si ato të konfliktit të interesave, konkurrencës, por pa u kufizuar në këto, mund të kërkojë *amicus curia* nga organizma të tjera, ajo vendos pezullimin e shqyrtimit të çështjes. Rishqyrtimi vijon menjëherë pas marrjes *amicus curia*.”

III.4.10. Në rastin konkret, duke qënë se pretendimet e ankimesit përbëjnë një çështje ligjore, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një organ tjetër, Autoriteti i Konkurrencës, i cili ka kompetencën lëndore të hetimit administrativ mbi ekzistencën ose jo të marrëveshjeve të ndaluara mes operatorëve ekonomikë, në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik, e cila përbën parakusht për zgjidhjen e themelit të ankimit administrativ pranë KPP, në datën 04.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 555/2023, ku vendosi si vijon:

1. Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë “Li.BO-Albania Branch” SHPK me nr.1250 prot, datë 31.05.2023 dhe “Trakmar” SHPK, me nr. 1257 prot, datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.
2. T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë Komisionin e Prokurimit Publik në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.
3. Të dërgojë, pranë Autoritetit të Konkurrencës, kopje të dokumentacionit të administruar në shqyrtimin administrativ nr.1257 Protokollin datë 01.06.2023.

III.4.11. Në datën 29.01.2024, është protokolluar në KPP, me nr. 1257/8 prot., shkresa e Autoritetit të Konkurrencës me nr. 36/5 prot., datë 25.01.2024, me objekt: “Njoftim vendimi”, bashkëngjitur Vendimi nr. 1049, datë 16.01.2024 me objekt: “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo-

*Albania Branch SHPK dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo- Albania Branch SHPK”, me përmbajtje si vijon:*

*Objekt: Mbyllja e procedurës së hetimit thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK, dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LLBO- Albania Branch SHPK.*

*Bazë ligjore: Neni 24, germa (d), neni 43, pika 5 dhe neni 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*

*Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:*

*- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;*

*Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK”;*

*Shpjegimet e paraqitura nga ndërmarrja Raimondo G.P SHPK nëpërmjet shkresës nr. 36 prot., datë 10.01.2024 “Objeksione dhe shpjegime të “Raimondo GP SHPK” mbi konkluzionet në Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e Prokurimit Publik referuar protokollin Tuaj 373/29 del 22.12.20023”;*

*Seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 10.01.2024 me përfaqësues të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;*

*Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi seancën dëgjimore të zhvilluar nga ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;*

**VËREN SE:**

**I. Procedura e ndjekur**

**1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) nëpërmjet shkresës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023) ka depozituar Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.BO- Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023”.**

**2. Në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 66 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 31, pika 3 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet Vendimit nr. 555/2023, ka vendosur:**

**a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit “objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.**



b) T'i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë KPP në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.

3. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet LI.BO-Albania Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, vihet re se:

Operatori Raimondo G.P SHPK dhe operatori LI.BO-Albania Branch SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.

- Gjithashtu sipas të dhënave në ekstrakt, të cilat njoftohen vullnetarisht rezulton se adresa e e-mailit dhe numri i telefonit fiks është i njëjtë për të dyja ndërmarrjet.

- Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;

Të dy operatorët nuk kanë plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik” dhe Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

4. Sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK përdorin skenën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të singertë.

5. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me Vendimin nr. 1000, datë 17.07.2023, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, për periudhën kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023.

6. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë: (i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca.

7. Në zbatim të Vendimit nr. 1000, datë 17.07.2023 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 373/3, datë 17.07.2023 “Autorizim inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë adresave të deklaruar në QKB të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch

*SHPK. Me paraqitjen e inspektorëve në adresën e përbashkët të dy subjekteve, u konstatua se në këtë adresë operonte ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK.*

8. *Ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK me objekt aktiviteti dhënien e asistencës sipërmarrësve dhe shoqërive në aktivitetin e menaxhimit të eksporteve në Shqipëri dhe jashtë vendit sidomos në ndërkombëtarizimin e bizneseve, është e kontraktuar nga ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHP për shërbime konsulence dhe kontabiliteti.*

9. *Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.*

10. *Ndërmarrja Raimondo G.P SHPK në datë 31.07.2023, dhe ndërmarrja Li.Bo - Albania Branch SHPK në datë 29.08.2023, janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku janë pyetur nga Sekretariati për 9ështjen objekt hetimi.*

11. *Gjatë inspektimit dhe nga takimet e realizuara pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka rezultuar se ndërmarrja Li.Bo në Itali është furnitor i ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK.*

12. *Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.*

13. *Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.*

14. *Për sa më sipër, periudhat hetimore të përcaktuara nga Autoriteti i Konkurrencës shtrihen në një afat kohor të gjatë, për të pasur kështu mundësinë e analizës të sa më shumë procedurave prokurimi ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Në rastin konkret, për arsye se ndërmarrja Raimondo G.P SHPK është regjistruar pranë QKB në datë 03.11.2021 dhe ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK është regjistruar pranë QKB në datë 20.10.2022, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar që periudha hetimore të jetë 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.*

15. *Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë: (i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si*

person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca

16. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor (Albanian Gas Service Company SHA).

## **II. Analiza e konkurrencës**

### **11.1 Tregu përkatës**

17. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.

18. Procedurat e prokurimeve publike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.

19. Nga informacioni i marrë gjatë procedurës hetimore nga APP me shkresën m. 373/8 prot., datë 31.07.2023, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimeve publike të autoritetit kontraktor Albanian Gas Service Company SHA.

20. Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet shkresës nr. 373 prot., datë 06.07.2023, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ për procedurën e prokurimit me nr. Ref. 66587-04-19-2023, dhe objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA.

21. Nëpërmjet shkresës nr. 373/8 prot., datë 31.07.2023 të depozituar nga Agjencia e Prokurimit Publik pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë sjellë të gjithë procedurat e prokurimit publik ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Raimondo G,P SHPK dhe Li.Bo — Albania Branch SHPK kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimit të hapura nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Service Company SHA. Nga 8 procedura ku ka marrë pjesë Raimondo G.P SHPK, në dy prej tyre, ka marrë pjesë edhe ndërmarrja Li.Bo — Albania Branch SHPK.

22. Gjatë periudhës kohore 26 shtator 2022 — 26 tetor 2023, ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:

Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që

është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues Raimondo G.P SHPK.

ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA (shpallur fitues një tjetër pjesëmarrës në procedurën e tenderit).

23. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu i prokurimit i veglave speciale dhe i pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG).

24. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaltueshmërisht homogjene.

25. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë

### **III. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve**

26. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD, “Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurimet Publike”.

27. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Albanian Gas Services Company SHA në rolin e autoritetit kontraktues, nga APP dhe KPP si edhe dokumentacioni i gjetur gjatë procedurave të inspektimit në Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në zyrën e ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK.

28. Gjatë periudhës kohore 26 shtator 2022 — 26 tetor 2023, ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:

Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që

është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues Raimondo G.P SHPK.

ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues një tjetër operator ekonomik pjesëmarrës në tender.

29. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin, si më poshte:

- Li.Bo - Albania Branch	3.592.000 lekë, skualifikuar
- Raimondo G.P	3.640.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	3.640.000 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	3.801.680 lekë, kualifikuar
- Ligus	4.100.000 lekë, kualifikuar
- Trinity Trade Company	4.198.000 lekë, kualifikuar

30. Ndërmarrja Li.Bo Albania Branch SHPK, renditur e para, është skualifikuar nga procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, për arsye, si më poshtë vijon:

- Ka dorëzuar në SPE kopje të pa noterizuara dhe pa vulë apostile të faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane LI.BO SRL.
- E njëjta gjë konstatohet edhe në Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015.
- Nuk plotëson kriterin për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

31. Ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK.

(i) Ndërmarrja Raimondo G.P ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen Prime Advisory Albania SHPK, ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj; (ii) Për ndërmarrjen Li.Bo - Albania Branch SHPK, Prime Advisory Albania SHPK ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se Li.Bo - Albania Branch SHPK, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë Prime Advisory Albania SHPK.

32. Faktet e mësipërme përbëjnë dhe elementin kryesor mbi të cilin ngrihet dyshimi se ndërmarrjet mund të përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord që njëri nga konkurrentët të paraqesë një ofertë e cila përmban terma specifike të cilat janë të papranueshme nga autoriteti kontraktues.

33. Gjatë inspektimit, rezultoi se ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK. Kjo ndërmarrje ka për objekt veprimtarie dhënien e asistencës për sipërmarrës dhe shoqëri në aktivitetin e tyre dhe ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK janë klientë të saj.

34. Ndërmarrja Raimondo G.P ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen Prime Advisory Albania SHPK ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj.

35. Për ndërmarrjen Li.Bo - Albania Branch SHPK, Prime Advisory Albania SHPK ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se, Li.Bo - Albania Branch SHPK, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë Prime Advisory Albania SHPK.

36. Nëpërmjet shkresës nr. 373/13 prot., datë 28.08.2023 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës, dërguar nga ndërmarrja AGSCo SHA), grupi i punës ka verifikuar DST që ka dërguar secili operator ekonomik që ka marrë pjesë në procedurën me referencë REF: 66587-04-19-2023. Të dyja ndërmarrjet kanë nga 29 dokumente secila, dokumente që kanë shërbyer për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Nga verifikimi i tyre rezultojnë me disa elementë të ngjashëm:

- Lista e çmimeve të artikujve.
- Formulari i Ofertës.
- Dy ekstrakte QKB për secilën ndërmarrje, të cilat janë printuar të dyja në të njëjtën datë por në orare të ndryshme.
  
- Tabelat që ndërmarrjet kanë përdorur për të ofertuar produktet janë të ngjashme, tabela e ndërmarrjes Li.Bo përkatësisht e titulluar “CIPS & DCVG table for tender” dhe tabela e ndërmarrjes Raimondo e titulluar “CIPS & DCVG table for tender”.
- Për noterizimin e Certifikatës ISO, të dy ndërmarrjet kanë vajtur tek e njëjta notere, Belinda V. Celaj, por në data të ndryshme.

37. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2- Vegla Speciale”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin si më poshtë:

- Raimondo G.P	3.984.750 lekë, kualifikuar
- AZ Trading	3.802.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	4.297.530 lekë, kualifikuar
- Vibtis	4.561.200 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	4.873.470 lekë, kualifikuar
- Li.Bo - Albania Branch	3.974.000 lekë, kualifikuar

38. Nëpërmjet shkresës nr. 373/13 prot., datë 28.08.2023 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës, dërguar nga ndërmarrja AGSCo SHA), grupi i punës ka verifikuar DST që ka dërguar secili operator ekonomik që ka marrë pjesë në procedurën me referencë REF: 66646-04-19-2023. Ndërmarrja Li.Bo Albania Branch ka bërë pjesë të procedurës së tenderit 26 dokumente ndërsa ndërmarrja Raimondo GP ka patur 23 dokumente që kanë shërbyer për

të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Nga verifikimi i tyre rezultojnë me disa elementë të ngjashëm:

i. *Formulari i Ofertës: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë të njëjtin gabim gramatikor në fillimin e paragrafit të dytë të Formularit të Ofertës, ku të dyjave i mungon e njëjta shenjë pikësimi dhe gjithashtu formatimi, fonti, stili dhe madhësia e shkrimit janë të njëjta.*

ii. *Lista e çmimeve të artikujve: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë të njëjtin formatim, fonti, stili dhe madhësia e shkrimit janë të njëjta .*

iii. *Sigurimi i Ofertës: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo e kanë bërë sigurimin e ofertës të ndërmarrja Sigma Inteialbanian dhe numri serial i policave është i njëpasnjëshëm, përkatësisht për Raimondo GP nr. i policës është 3914 dhe për Li.Bo nr. i policës është 3915.*

iv. *Kontratë Shërbimi: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë lidhur kontratë shërbimi për sistemin devPos me të njëjtën ndërmarrje Image & Communication Development SHPK.*

*Deklaratë e Energjisë Elektrike: Subjekti Prime Advisory Albania SHPK ka deklaruar për të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo në të njëjtën datë 01.03.2023, se ato kanë selinë qendrore dokumentare pranë zyrës së tij dhe për këtë arsye për të plotësuar Kriteret e Përgjithshme të tenderit deklaroi se Prime Advisory Albania ka kryer të gjitha pagesat kundrejt FSHU.*

vi. *Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë depozituar Shtojcën 6, e cila është e njëjtë për të dyja ndërmarrjet.*

vii. *Formulari i Specifikimeve Teknike: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë depozituar Shtojcën 5, të cilat janë të njëjta.*

39. *Nëpërmjet informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit të thelluar nga ndërmarrja Raimondo GP SHPK vihet re se flitet shpesh edhe në emër të ndërmarrjes Li.Bo Branch SHPK duke nënkuptuar një lloj dakordësie mes dy palëve, e cila në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës në të shkuarën ose në të ardhmen.*

40. *Në procedurën e hapur me objekt “Loti 2- Blerje vegla speciale”, asnjë nga ndërmarrjet në hetim nuk është shpallur fituese nga autoriteti kontraktor dhe si rrjedhojë sjellja e dy ndërmarrjeve nuk ka sjellë pasoja në konkurrencë në tregun e prokurimeve publike. Ndërsa procedura e hapur me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, është ndërprerë për shkak të ankesës të pranuar nga KPP, dhe si rrjedhojë sjellja e dy ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, nuk ka arritur të finalizohet duke mos u shpallur fitues asnjëri prej tyre.*

41. *Në vijim të konstatimeve nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me:*

i. *Ndërmarrjet Rajmondo GP SHPK dhe Li.Bo Albania Branch SHPK kanë të njëjtën seli ligjore, të njëjtën adresë e-maili dhe numër telefoni.*

*Lidhur me këtë konstatim, gjatë seancës dëgjimore është shpjeguar se pasja e një selie ligjore dhe një adrese e-mail dhe numër telefoni ka ardhur si pasojë e kontraktimit të ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK për shërbimet e konsulencës dhe kontabilitetit. Ndërmarrjet kanë shpjeguar se janë lënë kontaktet e Prime Advisory për shkak se komunikimet duhet të*

ishin në gjuhën shqipe dhe përfaqësuesit e ndërmarrjeve nuk e njohin gjuhën shqipe. Vetë Prime Advisory Albania SHPK kryen shërbimet e konsulencës dhe kontabilitetit për disa ndërmarrje të huaja.

ii. Ndërmarrjet Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo Albania Branch SHPK kanë disa dokumente që rezultojnë me elementë të ngjashëm.

Lidhur me këtë konstatim, ndërmarrjet kanë shpjeguar gjatë seancës dëgjimore se përkthimet kanë kërkuar ndihmën e Prime Advisory Albania, noterizimet janë kryer tek noteri i ndërmarrjes ku Prime Advisory referohet për procedura të ndryshme dhe dokumentacioni nga të tretë si sigurimi i ofertës, ekstraktet e QKB, etj., janë gjeneruar po nga ndërmarrja Prime Advisory Albania. Por dokumentacioni i lidhur me shumën e ofertuar është bërë në mënyrë të pavarur nga secila ndërmarrje.

iii. Informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit të thelluar nga ndërmarrja Raimondo GP SHPK, e cila flet dhe në emër të ndërmarrjes Li.Bo Branch SHPK.

Lidhur me këtë konstatim, ndërmarrja Raimondo GP SHPK në seancë dëgjimore ka shpjeguar se nuk ka folur në emër të Li.Bo Branch SHPK, por vetëm i është referuar si një ndërmarrje e lidhur në këtë proces hetimor.

42. Sa më sipër, për shkak të mënyrës se si ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK kryejnë aktivitetin në Shqipëri, duke qenë se Li.Bo ka qenë furnitor i Raimondo G.P SHPK si dhe gjithashtu për shkak se gjatë procedurës së inspektimit nuk janë gjetur evidenca direkte, për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e prokurimit me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo — ALBANIA të ketë shkelje të nenit 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121/2003.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në, nenin 24, germa (d), neni 43, pika 5 dhe nenin 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### VENDOSI:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.

II. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që brenda 90 ditëve të realizojnë ndryshimet përkatëse për të kryer një aktivitet të pavarur nga njeri tjetri dhe konkretisht:

i. Të ndryshojnë selinë e ushtrimit të aktivitetit;

ii. Të kenë adresa e-mail dhe numra telefoni të pavarur nga njëri tjetri;

III. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që kur marrin pjesë individualisht në procedurat e prokurimit publik të ofertojnë në mënyrë të pavarur.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”



III.4.12. Sa më sipër cituar, referuar në përgjithësi Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës, Komisionit të Konkurrencës nr. 1049 , datë 16.01.2024 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo- Albania Branch SHPK dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo GP SHPK dhe Li.Bo- Albania Branch SHPK”, dhe në veçanti pikës 43 të këtij vendimi, ku thuhet shprehimisht: “Sa më sipër, për shkak të mënyrës se si ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK kryejnë aktivitetin në Shqipëri, duke qenë se Li.Bo ka qenë furnitor i Raimondo G.P SHPK si dhe gjithashtu për shkak se gjatë procedurës së inspektimit nuk janë gjetur evidenca direkte, për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e prokurimit me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo — ALBANIA të ketë shkelje të nenit 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121/2003”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shoqëritë “Raimondo G.P” SHPK dhe “Li.Bo — ALBANIA BRANCHE” SHPK nuk ndodhen në kushtet e parashikuara në nenin 4, “Marrëveshjet e ndaluara” të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, ku parashikohet se: “Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që: a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave Marrëveshjet që ndalohen, sipas pikës 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas neneve 5, 6 dhe 7, janë të pavlefshme.”

Pretendimet e ankimuesit, nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur të operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: “*Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)*” me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05.05.2023, nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “TrakMar” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “TrakMar” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

